Energy Regulatory Office
Zyra e Rregullatorit per Energji
Regulatorni Ured za Energiju
www.ero-ks.org

Hamdi Mramori Street, No 1

Prishtina 10000 – Kosovo

Tel: +381 (0) 38 247 615 ext. 103

Fax: +381 (0) 38 247 620

e-mail: info@ero-ks.org

www.ero-ks.org

Prishtina, 23 maj 2007

# Aplikacioni plotësues i tarifave me pakicë të KEK Sh.a

## *Tarifat e propozuara të ZRRE-së*

## 1 Hyrje

1 Ky shënim shqyrton zgjedhjet për tarifa të reja me pakicë të cilat përputhen me të hyrat e lejuara të përshtatura gjatë rishqyrtimit. Për t'ju shmangur hutisë, në këtë shënim janë përdorur termet në vijim:

i) ***Tarifat ekzistuese*** i referohet tarifave të aprovuara më 1 korrik 2000, të cilat tashmë janë në fuqi.

ii) ***Tarifat e propozuara të ZRRE-së*** i referohet tarifave të reja me pakicë të propozuara nga ZRRE në këtë shënim.

2 Për secilën strukturë të tarifave, është siguruar informacion krahasues mbi:

i) Tarifën mesatare për secilën kategori të konsumatorëve dhe ndryshimin nga nivelet ekzistuese.

ii) Tarifën mesatare për konsumatorët në kategorinë 5 (0.4kV tension ku janë të lidhur konsumatorët shtëpiak me njehsorët dy tarifor), me konsum mujor prej 200kWh (të definuar si konsumatorë me 'nevoja minimale'), prej 600kWh (përafërsisht të barabartë me konsumatorin 'mesatar') dhe 1,000 kWh (konsumatorët e 'mëdhenj').

3 Ky informacion krahasues është siguruar në dy baza të ndryshme:

i) ***'Viti i plotë'***, që tregon ndryshimet që do të rezultonin nëse tarifat e reja me pakicë aplikohen nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2007. Për konsumatorin i cili llogaritë se si do të ndikojë në faturat e tij, ky do të jetë ndikimi i perceptuar (pasi që nuk pritet që konsumatorët të korrigjojnë për zbatimin e vonuar të tarifave të reja me pakicë). Kjo po ashtu është masa e përshtatshme nëse rishikimi i ardhshëm i çmimeve dhe hyrja e tarifave për 2008 pritet të shtyhet, në mënyrë që tarifat e reja me pakicë do të vazhdojnë të aplikohen për pjesën e parë të vitit 2008.

ii) ***'Viti i pjesërishëm*** që tregon ndryshimet të cilat do të rezultonin nëse tarifat e reja me pakicë do të aplikoheshin nga 1 prilli deri më 31 dhjetor 2007, me tarifat ekzistuese të cilat aplikohen përpara kësaj date. Ky është ndryshimi i tanishëm i pritur në faturat e konsumatorëve për vitin në tërësi, pas lejimit të hyrjes së shtyrë të tarifave të reja.

## 2 Tarifat e propozuara të ZRRE-së

4 Sipas këtyre tarifave të propozuara, të ardhurat e mbuluara prej secilës kategori të konsumatorëve prej 0 në 4 dhe 8 (konsumatorët jo-shtëpiak), mbesin të pandryshuara nga ato tarifa të miratuara. Të ardhurat totale të mbuluara nga kategoritë e konsumatorëve prej 5 në 7 (konsumatorët shtëpiak), janë reduktuar nëse krahasohet reduktimi i plotë në të ardhurat e lejuara që do të mbulohen nga të hyrat e lejuara prej tarifave të rregulluara me pakicë nga rishqyrtimi në vijim.

5 Përshtatjet që janë zbatuar për kategoritë e konsumatorëve individual janë përshkruara më poshtë.

**<u>Kategoria 0 – 110kv</u>**

6 Nuk ka ndryshim nga tarifat e miratuara.

**<u>Kategoria 1 – 35kV</u>**

7 Nuk ka ndryshim nga tarifat e miratuara.

**<u>Kategoria 2 – 10kV</u>**

8 Nuk ka ndryshim nga tarifat e miratuara.

**<u>Kategoria 3 – 0.4kV komerciale të mëdhenj</u>**

9 Gjatë diskutimeve më KEK Sh.a, është rivendosur fuqia e angazhuar dhe një çmim përkatës për këtë. Kjo i përgjigjet shqetësimeve të KEK Sh.a, që të hyrat e tyre janë shumë të varura nga çmimi i energjisë dhe pikëpamjes së shqyrtuar të KEK Sh.a, se keqpërdorimi i maksigrafëve nuk është një problem serioz.

10 Për koston reale të fuqisë së angazhuar dhe ate të energjisë është aplikuar një faktor i zakonshëm shkallëzues në modelin e kalkulimit, në mënyrë që të sigurohen të hyrat totale të mbuluara nga kjo kategori konsumatorësh e që janë të barabarta me ato sipas tarifave të miratuara. Kjo rezulton në reduktimin e çmimeve të energjisë prej niveleve sipas tarifave të aprovuara dhe rialokimi për fuqinë e angazhuar maksimale..

**Kategoria 4 – 0.4kV komerciale të vegjël**

11 Brenga është shprehur se niveli i çmimit për energji për këta konsumator (te cilët kanë te përfshire koston e fuqisë se angazhuar , e cila për konsumatorët tjerë industrial dhe komercial është mbuluar nëpërmjet tarifës për fuqi te angazhuar) ne mënyre te pamjaftueshme e ndare ne mes te tarifës se larte dhe te ulte . Atëherë te rregulluara për nivelin e njejt te hyrave qe mbulojnë ketë kategori te konsumatorëve por është zbatuar një kofiecient me i larte ( 2 here) ndermeje tarifës se larte dhe asaj te ulte ashtu si është bere edhe me rastin e konsumatorëve shtëpiak ( kategoria e 5).

12 **Kategoria 5 – 0.4kV shtëpiake (njehësorë dy tarifor)**

13 Tarifa dy kohëshe(natë-ditë) është rivendosur për këta konsumatorë, që zëvendësojnë paraqitjen e përkohshme një tarifore sipas "tarifave të miratuara" si përgjigje kërkesës së KEK Sh.a. Kjo pasqyron shqetësimet e KEK-Sh.a lidhur me kundërshtimin e suspendimit të tarifës dy kohëshe dhe shqetësimet e ZRRE-së se këta konsumatorë nuk do të kenë më rast t'i përshtatin profilin e konsumimit për të reduktuar faturat e energjisë elektrike (dhe po ashtu të reduktojnë sistemin total të kostos).

14 Ngarkesa fikse (konsumatori) është rritur në €2/konsumator/muaj (€24/konsumtor/vit). Kjo i përgjigjet shqetësimeve lidhur me vështirësitë praktike për të implementuar çmimin e mëparshëm (prej €20/konsumator/vit) sipas tarifave të miratuara duke shfrytëzuar sistemin e tanishëm të faturimit të KEK Sh.a.

15 Me këto përshtatje, kostoja reale e çmimit të energjisë së kalkuluar në modelin e konsumatorëve në bllokun e parë(0-200kWh/muaj) është shkallëzuar nga një faktor i zakoneshëm në mënyrë që tarifa mesatare për konsumatorin që konsumon vlerën më të madhe të këtij blloku (p.sh. 200kWorë/muaj) mbetet e pandryshuar nga niveli sipas tarifave ekzistuese (kalkuluar në bazë të vitit të plotë). Kjo është në pajtueshmëri me qasjen e miratuar nga "tarifat e miratuara". Kalkulimi përfshinë të gjitha çmimet e pagueshme nga konsumatori, duke përfshirë edhe çmimet e energjisë, çmimet e fuqisë së angazhuar dhe çmimet e kostos fikse..

16 Çmimet e energjisë së kostos reale të kalkuluara në model për konsumatorët në bllokun e dytë (201-600kWorë/muaj) janë shkallëzuar nga një faktor i zakonshëm në mënyrë që tarifa mesatare për një konsumator që konsumon vlerën më të madhe të këtij blloku, mbetet e pandryshuar nga niveli sipas tarifave ekzistuese ( të kalkuluara në bazë të vitit të plotë). Kjo pasqyron pikëpamjen e ZRRE-së se konsumatori shtëpiak mesatar (me konsumim të e përafërsisht 570kWorë/muaj) do t'i shohin tarifat e tyre në përgjithësi të pandryshuara.

17 Pagesat për energji që reflektojnë koston, në modelin për konsumatorët në bllokun e tretë (>600kWh/muaj) janë shkallëzuar nga një faktori i zakonshëm në mënyrë që totali i të hyrave të mbledhura nga tarifat e rregulluara për vitin 2007 janë në përputhje me ato të aprovuara nga ZRRE-ja pas rishqyrtimit (duke marrë parasysh përshtatjen me tarifat e konsumatorëve të tjerë, si më poshtë).

**Kategoria e amvisërisë 6 – 0.4kV (njehsorët një tarifor)**

18 E njëjta kosto fikse (të konsumatorëve) është aplikuar si për konsumatorët nën kategorinë 5.

19 Në "tarifat e aprovuara", çmimet për konsumatorët në këtë kategori janë vendosur të njëjta me ato të konsumatorëve në kategorinë 5 (të cilat përkohësisht janë kaluar në një tarifor). Kjo nuk qëndron më pas ndryshimeve që janë përshkruar më lart për çmimin e konsumatorëve në kategorinë 5.

20 Në vend të , pagesat e energjisë për konsumatorët e kësaj kategorie janë vendosur në atë mënyrë që shenjat e çmimi për konsumatorë të jenë të njëjta siç janë vendosur në kategorinë 5, si në vazhdim:

i) Raporti i çmimeve të energjisë në secilin blok me atë blokun pasues është i njejtë si për konsumatorët e kategorisë së 5

ii) Raporti i çmimeve të energjisë në sezonën e lartë atë të së ulët për secilin bllok është e njëjtë me atë të konsumatorëve në kategorinë 5.

21 Çmimet e energjisë për secilin bllok pastaj janë rregulluar duke zbritur në mënyrë që çmimi mesatar i arritshëm për që duhet të paguhet nga konsumatorët e kësaj kategorie të bie përafërsisht për 5%, për të qenë edhe më afër me çmimet e konsumatorëve nën kategorinë 5 (aktualisht, çmimi efektiv i energjisë – shuma e energjisë dhe fuqisë së angazhuar – e paguar nga këta konsumatorë është më e lartë se ajo e paguar nga konsumatorët e kategorisë 5)..

**<u>Kategoria e konsumatorëve shtëpiak 7 – 0.4kV (të pamatur)</u>**

22 Çmimet për këta konsumatorë kanë mbetur të pandryshuara nga tarifat ekzistuese. Bazuar në njësi, këto çmime janë mbi ato që janë të aplikueshme për konsumatorët e matur, duke pasur për synimin që konsumatorët e pamatur të vendosin matësit.

**<u>Kategoria 8 – Ndriçimi Publik</u>**

23 Nuk ka ndryshim nga tarifat e aprovuara.

24 Tarifat që janë llogaritur janë paraqitur në Figura 1, afër "tarifave ekzistuese", "tarifat e aprovuara" dhe "tarifat e propozuara" të KEK-ut. Në figurën 3 paraqiten ndryshimet mesatare që kanë rezultuar për konsumatorët e kategorisë 5 sipas niveleve (blloqeve) të ndryshme të konsumit në bazë të vitit të plotë dhe një pjese të vitit.

Figura 1: Tarifat me pakicë të propozuara nga ZRRE

**Propozuar nga ZRrE (22 Maj 2007)**

| Grupi Tarifor | Niveli i tensionit të furnizimit | Elementet tarifore | Njësia | Koha gjatë ditës (a) | Ekzistuese: Sezona e lartë (1 tetor - 31 mars) | Ekzistuese: Sezona e ulët (1 prill - 30 shtator) | Propozuar nga ZRrE (22 Maj 2007): Sezona e lartë (1 tetor - 31 mars) | Propozuar nga ZRrE (22 Maj 2007): Sezona e ulët (1 prill - 30 shtator) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 | 110kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 34.00 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €c/kW | | 1,150.00 | 895.00 | 519.00 | 519.00 |
| | | Energjia aktive (P), prej të cilës: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 2.68 | 2.11 | 6.03 | 1.78 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 1.34 | 1.09 | 2.50 | 1.47 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €c/kVArh | | 1.41 | 1.15 | | |
| 1 | 35kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 30.00 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €c/kW | | 1,278.00 | 959.00 | 540.00 | 540.00 |
| | | Energjia aktive (P), prej të cilës: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 3.20 | 2.56 | 6.30 | 2.73 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 1.60 | 1.28 | 3.33 | 2.47 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €c/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 0.04 | 0.04 |
| 2 | 10kV | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 34.00 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €c/kW | | 1,278.00 | 959.00 | 466.00 | 466.00 |
| | | Energjia aktive (P), prej të cilës: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 3.52 | 2.81 | 7.07 | 3.15 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 1.76 | 1.41 | 3.81 | 2.87 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €c/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 0.32 | 0.32 |
| 3 | 0.4kV Kategoria I (konsumatorët me shpenzim të energjisë reaktive) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 29.00 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €c/kW | | 852.00 | 631.00 | 270.00 | 270.00 |
| | | Energjia aktive (P), prej të cilës: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 5.11 | 3.83 | 7.85 | 4.36 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 2.56 | 1.92 | 4.95 | 4.11 |
| | | Energjia reaktive (Q) | €c/kVArh | | 1.28 | 0.96 | 1.53 | 1.53 |
| 4 | 0.4kV Kategoria II | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 34.00 | |
| | | Fuqia e angazhuar | €c/kW | | 253.00 | 189.00 | | |
| | | Energjia aktive (P) | €c/kWh | Tarifa e vetme | 7.57 | 5.68 | 9.68 | 6.26 |
| | | Energjia aktive (P), prej të cilës: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 9.47 | 6.94 | 11.64 | 7.63 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 5.05 | 3.79 | 5.82 | 3.81 |
| 5 | 0.4kV matësi 2-tarifor (2-vlerësh) shtëpiak c) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 24.00 | |
| | | Energjia aktive (P), për konsum: | | | | | | |
| | | <200 kWh/muaj (Blloku i parë) | €c/kW | | 144.00 | 115.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | 200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) | €c/kW | | 144.00 | 115.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i tretë) | €c/kW | | 192.00 | 144.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | Energjia aktive (P), për konsum: | | | | | | |
| | | <200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 4.80 | 3.83 | 4.42 | 3.17 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 2.40 | 1.92 | 2.21 | 1.58 |
| | | 200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 4.80 | 3.83 | 5.97 | 4.28 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 2.40 | 1.92 | 2.99 | 2.14 |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit: | €c/kWh | Tarifa e lartë | 7.67 | 5.75 | 8.67 | 6.21 |
| | | | €c/kWh | Tarifa e ulët | 3.83 | 2.88 | 4.33 | 3.11 |
| 6 | 0.4kV matësi 1-tarifor (1-vlerësh) shtëpiak c) | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 24.00 | |
| | | Energjia aktive (P), për konsum: | | | | | | |
| | | <200 kWh/muaj (Blloku i parë) | €c/kW | | 144.00 | 115.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | 200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) | €c/kW | | 144.00 | 115.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i tretë) | €c/kW | | 192.00 | 144.00 | 0.00 | 0.00 |
| | | Energjia aktive (P), për konsum: | | | | | | |
| | | <200kWh/muaj (Blloku i parë) prej të cilit: | €c/kWh | Tarifa e vetme | 3.99 | 3.20 | 3.94 | 2.82 |
| | | 200-600 kWh/muaj (Blloku i dytë) prej të cilit: | €c/kWh | Tarifa e vetme | 3.99 | 3.20 | 5.32 | 3.81 |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i tretë) prej të cilit: (d) | €c/kWh | Tarifa e vetme | 6.39 | 4.80 | 7.72 | 5.53 |
| 7 | 0.4kV (shtëpiak pa matës) | Konsumi i vlerësuar <400kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 20.00 | 20.00 | 20.00 | |
| | | Konsumi i vlerësuar 400-800kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 36.00 | 36.00 | 36.00 | |
| | | Konsumi i vlerësuar >800kWh/muaj | €/konsumator/muaj | | 61.00 | 61.00 | 61.00 | |
| 8 | Ndriqimi publik | Tarifa fikse e konsumatorit | €/konsumator/vit | | | | 34.00 | |
| | | >600 kWh/muaj (Blloku i tretë) | €c/kWh | Tarifa e vetme | 8.21 | 6.31 | 7.82 | 7.82 |

*a* *Tarifa e lartë aplikohet prej 07:00-22:00 e Hënë-e Shtunë gjatë sezonës së lartë dhe prej 08:00-23:00 e Hënë-e Shtunë gjatë sezonës së ulët*
*b* *Aty ku nuk është I instaluar maksigrafi (kategoria 4-6) kërkesa ekzistuese llogaritet si volumi I energjisë së konsumuar sipas tarifës së lartë duke pjestuar me 100*
*c* *Konsumatorët e regjistruar si raste sociale ngarkohen me normë zero*
*d* *Sipas tarifave ekzistuese, kjo tarifë aplikohet për konsumin >800kWh/muaj*

Figura 2. Ndikimi i tarifave të reja ne konsumatorët shtëpiak

## Ndikimi i tarifave të reja në konsumatorët shtëpiak

### Aprovuar (15 Mars 2007)

| 0.4 kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy vlerëshe) | Konsumimi mujor | Ekzistuese | | Krahasimi vjetor | | | Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi 1 Prill 2007) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Ndrysh. | Fatura (periudha e 1) | Fatura (periudha e 2) | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Ndrysh. |
| | kWh | € | €c/kWh | € | €c/kWh | | € | € | € | €c/kWh | |
| Nevoja minimale | 200 | 92 | 3,84 | 93 | 3,86 | 0,4% | 27 | 65 | 92 | 3,84 | 0,0% |
| Konsumatori mesatar | 600 | 277 | 3,84 | 292 | 4,05 | 5,4% | 81 | 203 | 284 | 3,94 | 2,7% |
| Konsumatorët e mëdhenj | 1.000 | 508 | 4,23 | 652 | 5,44 | 28,5% | 154 | 441 | 595 | 4,96 | 17,2% |

### Propozuar nga ZRrE (22 Maj 2007)

| 0.4 kV Konsumatorët shtëpiak (tarifa dy vlerëshe) | Konsumimi mujor | Ekzistuese | | Krahasimi vjetor | | | Krahasimi i pjesëshëm vjetor (tarifat e reja hynë në fuqi 1 Prill 2007) | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Ndrysh. | Fatura (periudha e 1) | Fatura (periudha e 2) | Fatura vjetore | Çmimi mesatar | Ndrysh. |
| | kWh | € | €c/kWh | € | €c/kWh | | € | € | € | €c/kWh | |
| Nevoja minimale | 200 | 92 | 3,84 | 92 | 3,84 | 0,0% | 27 | 65 | 92 | 3,84 | 0,1% |
| Konsumatori mesatar | 600 | 277 | 3,84 | 276 | 3,84 | -0,1% | 81 | 193 | 274 | 3,81 | -0,9% |
| Konsumatorët e mëdhenj | 1.000 | 508 | 4,23 | 544 | 4,54 | 7,2% | 154 | 371 | 525 | 4,37 | 3,4% |